



BASHKIA HIMARË

Udhëzues Operacional

Për zbatimin e projektit «Programi i nxitjes së punësimit të biznesit t'inor»

Miratimi

Ky udhëzues u hartua nga Bashkia Himarë, Drejtoria çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë duke u bazuar në praktikat më të mira nga rajoni i Ballkanit.

Nëntor 2024

Tabela e përmbajtjes

Shkurtime dhe akronime	4
1. Hyrje	5
2. Elementet kyç.....	6
2.1. Informacion i përgjithshëm.....	6
2.2. Aplikantët e pranueshëm.....	6
2.3. Shuma e grantit	7
2.4. Pranueshmëria e aktiviteteve dhe shpenzimeve të biznesit	7
2.5. Mbulimi gjeografik	10
3. Organet e projektit	11
3.1. Organet e menaxhimit.....	11
3.2. Organet operacionale dhe të mbështetjes.....	12
4. Udhëzuesi për zbatimin.....	13
4.1. Fushata informuese dhe mbledhja e aplikimeve (Ideve të biznesit)	14
4.2. Përzgjedhja e aplikantëve	15
4.3. Pjesëmarrja në trajnim, zhvillim, dhe paraqitja e planeve të biznesit.....	17
4.4. Vlerësimi dhe përzgjedhja e planeve më të mira të biznesit dhe dhënia e çmimeve.....	18
4.5. Kontraktimi dhe përdorimi i fondeve	20
4.7. Monitorimi dhe vlerësimi	21
Anekset	22
Aneksi 1 – Njoftim publik	23
Aneksi 2 – Njoftim i takimeve informuese.....	27
Aneksi 3 –Formular aplikimi për ide biznesi.....	28
Aneksi 4 – Formulari i vlerësimit për aplikimin e ideve të biznesit.....	32
Anksi 5 – Procesverbali i vlerësimit te ideve te biznesit	33
Anksi 6 – Format i plan biznesit.....	33
Aneksi 7 – Listë kontrolli e dokumenteve të dorëzuara të aplikimit për grantin.....	41
Aneksi 8 – Procesverbali i takimit të verifikimit administrativ	42
Aneksi 9 – Formulari i vlerësimit për planin e biznesit.....	43
Aneksi 10 – Procesverbali i takimit për vlerësimin e planit të biznesit.....	45
Aneksi 11 – Njoftim për aplikantët.....	46
Aneksi 12 – Kontrata për dhënien e grantit	48
Aneksi 13 – Raporti për përdorimin e grantit	51
Anksi 14 – Formulari i monitorimit.....	52

Shkurtime dhe akronime

QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
UO	Udhëzues Operacional
Projekti	Projekti 'Programi i nxitjes së Punësimit të Biznesit Rinor.'

1. Hyrje

Sipërmarrja ka provuar se është në vetvete një katalizator për rritjen ekonomike në shumë shtete. Po të njëjtën rëndësi ka edhe roli shumë i madh që luajnë te rinjte në rritjen e nivelit ekonomik. Grantet për të rinjtë, ndihmojnë në rritjen krijimin e kushteve të barabarta përmes ofrimit të ndihmës financiare që u mundëson atyre të konkurrojnë në tregun e sotëm. Fuqizimi ekonomik i të rinjve, nëpërmjet rritjes së aksesit në tregjet e punës edhe nëpërmjet përmirësimit të mundësive për sipërmarrjen e tyre është një politike që gradualisht po fiton vëmendje në politikën e qeverisë shqiptare si një mjet për të garantuar konsolidimin e të drejtave të rinjve.

Për ta vazhduar më tej këtë shtysë dhe për të bërë të mundur suksesin e financimit të veçantë të vitit 2025 e ne vazhdim, për të rinjtë sipërmarrës, Bashkia e Himarës prezanton Zbatimi e «Programit i nxitjes së punësimit të biznesit rinor» që ushtronin aktivitetin e tyre në Himarë. Programi synon të krijoj lehtësi për ngritjen e biznesit rinor që do të ketë sipërmarrës të rinjtë, nga të gjitha kategoritë të cilët me projektet dhe propozimet e tyre bindëse, por dhe konkuruuese, do ti japin vetes mundësi punësimi e për më tepër prioritet hapjes së vendeve të reja të punës nga vetë ata. Projekti kontribuon në punësimin e personave të papunë, duke pasur në vëmendje edhe vajza e djem me aftësi të kufizuara të cilëve jo vetëm u përmirëson standartin e jetesës por i bën të ndihen të vlefshëm për shoqërinë dhe pjesë e saj. Do të vlerësohen ato projekte, që janë më novatore, fitimprurëse por edhe në përputhje me politikën e Bashkisë së Himarës që ofrojnë një plan-biznesi bindës dhe konkuruues.

Ngritja e një biznesi rinor do të përfshi moshat e reja nga 18 deri 35 vjec. Përfitues do të jenë ata të rinj të cilët kanë kurajon e sipërmarrjes për të krijuar një natyrë biznesi të suksesshme duke paraqitur një plan-biznesi të detajuar, duke qenë këmbëngulës dhe të përkushtuar në arritjen e synimeve, entuziast dhe krijues, ambiciozë dhe me besim në vetvete. Nuk do të ketë avantazhe të mirëfillta sa u përket lehtësive fiskale, sepse do të operohet si çdo biznes tjetër, pra do të kryhen pagesat në shtet si dhe të gjitha detyrimet që lindin. Cdo do ta bënte një gjë të tillë, pra do të hapte një biznes, nëse gjithçka do të ecte mirë atëherë ai do të arrinte të siguronte edhe të ardhura për veten, por edhe do të krijonte kushte për rritjen e biznesit. Në biznes duhet të ofrohen shërbime standarde dhe të gjithë marrin një pagë dhe pjesa e fitimit nuk shpërndahet te akcionerët, por ri-investohet.

Elementet kyç të projektit përfshijnë një proces aplikimi të drejtë dhe konkuruues, trajnim në aftësi bazë të biznesit, përgatitje të një plani biznesi të shëndoshë dhe të zbatueshëm, mbështetje financiare (nëpërmjet ofrimit të granteve) për të filluar biznesin, dhe udhëheqje. Ky Udhëzues Operacional (UO) ofron orientim për procesin e zbatimit të projektit. Dokumenti përmban seksionet e mëposhtme:

Seksioni 1: ofron një prezantim të përgjithshëm të projektit;

Seksioni 2: përkufizon elementet kyç të projektit;

Seksioni 3: përfshin informacion për menaxhimin e fondit dhe organet e zbatimit;

Seksioni 4: përshkruan procedurat hap pas hapi për zbatimin e projektit.

Seksioni 5: formularët dhe dokumentet e nevojshme të përfshirë si anekse në këtë UO.

2. Elementet kyç

2.1. Informacion i përgjithshëm

Fondi në ndihmë të krijimit të biznesit rinor, i financuar nga programi i nxitjes dhe mbështetjes për zhvillim ekonomik dhe i projektuar për të mbështetur krijimin ose zgjerimin e aktiviteteve të zbatueshme të biznesit nga të rinjtë, të aftë për të pasur sukses në një treg konkurrues. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve synon të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të ndershme, dhe të mbështesë idetë më të mira, unike dhe të besueshme dhe planet e biznesit që garantojnë rezultate të qëndrueshme.

Përzgjedhja e aktiviteteve më të mira të biznesit do të kryhet në tre faza :

Së pari, kandidatët e pranueshëm aplikojnë me një ide biznesi, për t'u pranuar që të marrin pjesë në projekt.

Së dyti, aplikantët e pranuar trajnohen mbi aftësitë e përgjithshme të biznesit dhe zhvillimin e planit të biznesit, dhe vetëm pas kësaj ata mund të paraqesin planet e tyre të biznesit. Planet e biznesit do të jenë një version më i shtjelluar i idesë së biznesit.

Së treti, fituesit e shpallur (në rastin e bizneseve të reja (start-up), si fillim ata regjistrojnë bizneset e tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nënshkruajnë një kontratë 18-mujore për të marrë financime në formë granti dhe mbështetje për udhëheqje.

2.2. Aplikantët e pranueshëm

Projekti është projektuar për kandidatët me një ide të qartë biznesi, që synon fillimin ose zgjerimin e një biznesi të pavarur të vogël ose shumë të vogël. Kandidatët e përzgjedhur janë të detyruar të marrin pjesë personalisht në të gjitha aktivitetet e projektit, pasi ata janë drejtpërdrejt të përfshirë në zhvillimin dhe zbatimin e biznesit të tyre.

Kandidatët e kualifikuar dhe pjesëmarrësit e projektit janë të rinj që jetojnë dhe/ose kanë biznese të vogla ose shumë të vogla në territorin e Bashkisë së Himarës, në momentin e aplikimit, duke qënë banorë efektivë të këtij qyteti. Secili aplikant mund të marrë pjesë vetëm me një ide biznesi, ku e drejta për të marrë pjesë në projekt dhe për të pasur akses në asistencën me grante mund të përdoret vetëm një herë në vit.

- Te rinjtë e grupeve të mëposhtme do të kenë prioritet¹.
- Të rinj /të reja (18-35 vjeç) dhe banorë efektivë të Himarës;(kriter kryesor)
- Të rinj nga zonat rurale të Bashkisë së Hmarës;
- Të rinj me aftësi të kufizuara;
- Të rinj dhe të reja, me njërin prind me aftësi të kufizuar ose gëzojnë statusin e jetimit.
- Të rinj dhe të reja të papunë që nuk u përkasin kategorive më lartë.
- Të rinj dhe të reja të rikthyer nga emigracioni ose që duan të rikthehen si një mundësi për të qëndruar në Himarë.

2.3. Shuma e Grantit

Çdo përfitues i këtij projekti do të mbështetet me numri i përfituesve do të varet nga shuma që do të ketë në dispozicion Drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë ne çdo vit kalendarik.

¹ Gjatë procesit të vlerësimit të idesë së biznesit, aplikantët nga këto grupe mund të marrin deri në 5 pikë (nga 100) më shumë sesa aplikantët e tjerë. Më shumë informacion paraqitet në Formularin e Vlerësimit të Idesë së Biznesit.

Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i miratuar çdo vit për Bashkinë Himarë për projektin "Programi i nxitjes së punësimit të biznesit rinor".

Në zbatim të pikës 2 të këtij vendimi, buxheti që do të miratohet çdo vit për këtë projekt do të planifikohet duke ju referuar ecurisë së projektit të vitit parardhës dhe mundësive financiare për përfshirjen në buxhetin e Bashkisë Himarë të viteve në vijim për secilin plan biznesi të zhvilluar me sukses, i cili është pranuar gjatë procesit të përzgjedhjes, së bashku me asistencën për udhëheqje deri në dy vite pas fillimit të zbatimit të planit të biznesit.

Aplikantët e përzgjedhur mund të planifikojnë për financim shtesë duke përdorur instrumente financiare (kredi, hua, grante, etj.) të disponueshme në Shqipëri nëpërmjet institucioneve financiare ose projekteve të financuara nga donatorë, ose me financat e tyre. Nëse instrumenti financiar do të përdoret së bashku me asistencën e grantit për fillimin e planit të biznesit, atëherë ky burim financiar duhet të përfshihet në planin e biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit. Nëse instrumenti financiar do të përdoret për zgjerim të mëtejshëm të biznesit, kjo mbështetje shtesë e përfituar pritet që vetëm të raportohet në vizitat e monitorimit dhe raportet e projektit.

2.4. Pranueshmëria e aktiviteteve dhe shpenzimeve të biznesit

Aktivitetet e pranueshme të biznesit janë nga sektorët e mëposhtëm:

- Bizneset rurale;
- Turizmi;
- Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK);
- Biznes eco-friendly (miqësor me natyrën);
- Shërbime;
- Artizanale.
- Bujqësi/ Blegtori

Sektorët mund të ndryshojnë përgjatë secilit vit, në varësi të prioriteteve të përcaktuara nga bashkia.

Prioritet do u jepet aplikantëve:

- me ide biznesi unike (jo të përsëritura ndërmjet aplikantëve) ose që ofrojnë produkte/shërbime të reja,
- me biznese që ndodhen në zonat rurale të Bashkisë së Himarës,
- që përdorin zgjidhje teknike dhe teknologji prodhimi të reja dhe/ose që kursejnë energji,
- që përdorin burime të energjisë së rinovueshme
- me biznese që krijojnë më shumë se 3 mundësi punësimi dhe
- me biznese që japin mundësi punësimi kategorive vunerabël si gra të dhunuara etj.

Pavarësisht sektorit të zgjedhur, idetë e mëposhtme të biznesit nuk janë të pranueshme për të qenë pjesë e projektit:

- ❖ shërbime të pasurive të patundshme, qiraja për pasuri të tundshme;
- ❖ shërbime financiare dhe sigurimesh, dhe shërbime që përfshijnë lojërat e fatit;
- ❖ prodhim pijesh me përmbajtje dhe esencë të lartë alkooli;
- ❖ prodhim produktesh duhani;
- ❖ prodhim dhe shpërndarje armësh;

- ❖ prodhim duke përdorur teknologji që shkakton ndotje mjedisore (siç është ndotja e ajrit, ujit, tokës, etj).

Shpenzimet e pranueshme që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- qiranë për mjediset për zyra dhe shërbimet e biznesit;
- blerjen e materialeve për mobilim ose rregullim të mjediseve/godinave për biznesin;
- blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si edhe software dhe asete të tjera jo të prekshme;
- blerjen para fillimit të materialeve të papërpunuara dhe produkteve të konsumueshme;
- rrogat dhe pagat, dhe shërbime të tjera të specializuara të nevojshme, kontabilitet, administrim, IT, etj ;
- promovimin dhe reklamimin e aktiviteteve.

Ka disa kufizime për shpenzimet e pranueshme:

- blerja e materialeve të papërpunuara mund të mbulohet vetëm një herë, si blerje e vetme e stokut fillestar;
- rrogat dhe pagat mund të mbulohen deri për nente muaj pas fillimit të biznesit, bazuar në rrogën mesatare në Shqipëri (pjesa tjetër e rrogës duhet të mbulohet nga vetë biznesi);

Shpenzimet jo të pranueshme që nuk mund të mbulohen nga paratë e grantit përfshijnë:

- ❖ blerjen e pasurive të patundshme si toka, godina, etj ;
- ❖ blerjen e mjeteve të transportit që nuk do të përdoren direkt për funksionimin e biznesit të propozuar;
- ❖ çdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar;
- ❖ shpenzimet e kryera përpara përmblylljes së kontratës së grantit.

Shpenzimet jo të pranueshme në grant mund të mbulohen nëpërmjet kontributit personal të aplikantit, dhe formave të tjera të financimit, siç janë kreditë, huaja, etj.

2.5. Mbulimi gjeografik

Në vitin 2025, projekti po zbatohet në territorin e Bashkisë së Himarës duke përfshirë këtu dhe dy njësitë administrative si Lukovë dhe Horë-Vranisht .

3. Organet e projektit

Projekti i fondit të biznesit rinor po zbatohet nga Bashkia e Himarës nëpërmjet Drejtorisë së çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë si dhe drejtori të tjera që do të përfshihen në disa hapa konkretë të zbatimit, janë si në vijim:

- Drejtoria juridike
- Drejtoria e financës, e planifikimit të buxhetit dhe e integritimit evropian
- Drejtoria e të ardhurave
- Drejtoria e turizmit, kulturës dhe sportit
- Drejtoria e shërbimeve publike dhe mirëmbajtjes
- Drejtoria e bujqësisë, pyjeve, kullotave dhe i ujitjes

Projekti po zbatohet nga organet e mëposhtme:

- ✓ Komisioni i vlerësimit
- ✓ Koordinator i projektit/sekretari i komisionit
- ✓ Mentorë

3.1. Organet e menaxhimit

Komisioni për Vlerësimin

Komisioni për vlerësimin do të përbëhet nga 7 anëtarë konkretish nga:

- (1) një përfaqësues nga Drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë
- (1) një përfaqësues nga Drejtoria juridike
- (1) një përfaqësues nga Drejtoria e financës, e planifikimit të buxhetit dhe e integritimit evropian
- (1) një përfaqësues nga Drejtoria e të ardhurave
- (1) një përfaqësues nga Drejtoria e turizmit, kulturës dhe sportit
- (1) një përfaqësues nga Drejtoria e shërbimeve publike dhe mirëmbajtjes.
- (1) një përfaqësues nga Drejtoria e bujqësisë, pyjeve, kullotave dhe i ujitjes.

Ky komision do të ngrihet dhe emërohet me Urdherin e Kryetarit të Bashkisë së Himarës.

Takimet e komisionit do të organizohen në zyrën e Drejtorisë së çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë. Paneli do të kryesohet nga përfaqësuesi i kësaj drejtorie si dhe emrat e anëtarëve të komisionit nuk do të bëhen publikë para publikimit të rezultateve përfundimtare.

Anëtarët e komisionit do të mblidhen fillimisht për të vlerësuar secilin aplikim për ide biznesi në mënyrë të pavarur, bazuar në kriteret e përcaktuara.

Së dyti, komisioni do të bëjë një verifikim administrativ të planeve të paraqitura të biznesit sipas kriterëve të përcaktuara.

Së treti, komisioni do të shqyrtojë opinionet dhe pikët e dhëna nga këshilltarët e pavarur të vlerësimit për secilin plan biznesi sipas kriterëve të përcaktuara. Nëse është e nevojshme, këshilltarët, trajnuesit dhe/ose kandidatët mund të ftohen në takim për shpjegime të mëtejshme. Komisioni mund të kërkojë vlerësim shtesë nëse është e nevojshme dhe të bjerë dakord ose të ndryshojë shumë e kërkuar të grantit. Së fundi, komisioni rendit planet e biznesit sipas pikëve përfundimtare për secilin plan biznesi (mesatarja e pikëve individuale të dhëna nga secili këshilltar).

Anëtarët e komisionit duhet të bien dakord me rezultatet përfundimtare dhe listën e pranuar të planeve të biznesit për financim. Koordinatori i projektit vepron si sekretar gjatë takimeve dhe harton procesverbalin e takimeve.

3.2. Organet operacionale dhe të mbështetjes

Koordinatori i projektit :

Një përfaqësues i Drejtorisë së çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë në Bashkinë e Himarës shërben si Koordinator projekti dhe është përgjegjës i menaxhimit operacional të projektit. Koordinatori është përgjegjës për zbatimin në kohë të të gjitha aktiviteteve të projektit dhe ndjek kalendarin e miratuar. Gjithashtu, ai/ajo organizon takimet e komisionit të vlerësimit, siguron shpërndarjen e dokumenteve tek ata, si edhe mbledh firmat nga të gjithë anëtarët e komisionit . Koordinatori është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha dokumenteve të projektit dhe ruajtjen në drejtori dhe i mban ato në arkiv për të paktën 2 vite pas përfundimit të projektit.

4. Udhëzuesi për zbatimin

Trajnuesit :

Trajnuesit (një ose dy) në planifikimin e biznesit do të ofrojnë trajnim për aplikantët e përzgjedhur, 40 orë (10 gjysma ditësh pune në total). Qëllimi i tyre do të jetë të mësojnë të rinjtë se si mundet të ndërtohet një plan biznesi i qëndrueshëm. Kostot e trajnuesit do të mbulohet si shërbim nga Bashkia Himarë.

Ekspertet për vlerësimin :

Të paktën dy (2) këshilltarë të pavarur (ekspertë) të cilët mund të jenë edhe trajnuesit e planifikimit të plan bizneseve, do të vlerësojnë secilin plan biznesi të paraqitur dhe do të jenë përgjegjës për to. Ata do t'i japin opinionin e tyre me shkrim komisionit dhe mundet të jenë të pranishëm në takimet e komisionit për këshillime të mëtejshme.

Këshilltarët do të caktohen nga bashkia, për të bërë një vlerësim për secilin nga planet e paraqitura të biznesit, sipas sistemit të pikëzimit dhe rregullave të përcaktuara në këtë UO. Secili plan biznesi duhet të vlerësohet nga dy (2) këshilltarë. Nëse pikët përfundimtare të secilit prej këshilltarëve ndryshojnë nga njëri-tjetri me më shumë se 20 pikë, atëherë një këshilltar i tretë duhet të japë opinionin dhe pikët e tij/saj. Kostot financiare të ekspertëve në këtë proces do të mbulohet nga Bashkia Himarë .

Koordinatori i projektit, dhe 2 mentorët e projektit do të emërohen zyrtarisht nga Kryetari i Bashkisë. Projekti i fondit për krijimit të biznesit rinor, do të zbatohet në një cikël që ndjek shtatë hapat e mëposhtëm:

- Fushata informuese dhe mbledhja e aplikimeve (Ideve të biznesit);
- Përzgjedhja e aplikantëve;
- Paraqitja e planeve të biznesit;
- Vlerësimi dhe përzgjedhja e planeve më të mira të biznesit dhe dhënia e çmimeve;
- Kontraktimi dhe përdorimi i fondeve;
- Udhëheqja;
- Monitorimi dhe vlerësimi.

4.1. Fushata informuese dhe mbledhja e aplikimeve (Ideve të biznesit)

Fushata informuese :

Një fushatë informuese tre-javore do të organizohet duke pasur si objektiv aplikantët e pranueshëm, të gjitha OJF-të/institucionet/partnerët që mund të informojnë të rinjtë, që jetojnë në zonat urbane dhe rurale të Bashkisë.

Një njoftim publik (Aneksi 1) do të hartohet nga koordinatori i projektit. Njoftimi duhet të përfshijë informacion për tërësinë e procesit të aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë. Ai duhet të përfshijë gjithashtu informacion për çdo takim informues që do të organizohet gjatë tre javëve. Njoftimi do të publikohet nëpër faqet zyrtare të bashkisë si në media lokale. Gjithashtu, njoftimi duhet të publikohet edhe në ato institucione të tjera vendore (zyrat e punësimit, OJF dhe zona të tjera ku ka një lëvizje të madhe). Formulari i aplikimit për ide biznesi duhet të hidhet online, si edhe të jetë në dispozicion në kopje të printuara në zyrën pritëse në bashki dhe njësitë administrative përkatëse.

Takimet informuese (Aneksi 2) duhet të organizohen në vende të ndryshme në territorin e Bashkisë për të transmetuar informacionin e nevojshëm të të gjithë aplikantët në një mënyrë të standardizuar dhe të njëjtë. Synimi i këtyre takimeve do të jetë shpërndarja e informacionit të aplikantët e mundshëm të pranueshëm që në të kundërt do të kenë akses të

kufizuar te kanalet formale të komunikimit. Takimet do të publikohen në faqe interneti, media dhe mjete të tjera të komunikimit. Takimet informuese do të organizohen gjatë dy javëve të para të fushatës. Duke përdorur një qasje hap pas hapi, aplikantët informohen për kushtet e përgjithshme të projektit, procedurat e aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë. Së fundmi, formulari i aplikimit për ide biznesi (Aneksi 3) do të jetë në dispozicion gjatë këtyre takimeve.

Për më tepër, projekti do të promovojë kanalet e tjera të medias, siç janë konferencat për shtyp, artikujt e gazetave, revistat dhe gazetatat, portalet e punësimit, kryeartikujt të veçantë online nëpërmjet medias sociale dhe nga kanale dhe aktivitete të tjera të marrëdhënieve me publikun të përdorura nga bashkia.

Dorëzimi/mbledhja e formularëve të aplikimit për ide biznesi :

Të gjitha publikimet, takimet informuese, njoftimet dhe materialet e tjera do të ofrojnë informacion për aplikantët e interesuar mbi afatet e dorëzimit dhe procesin e përzgjedhjes. Të gjithë Formularët e Aplikimit për Ide Biznesi të plotësuar duhet të dorëzohen pranë sektorit të pritjes me qytetarin, në Bashki. Aplikantët duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit për ide biznesi në origjinal dhe në dy kopje të tjera identike. Aplikantët janë të detyruar të paraqesin dokumentacione shtesë, në dokumentet e formularit të aplikimit për ide biznesi, që provojnë arsimin, kualifikimin dhe përvojën e tyre lidhur me idenë e paraqitur të biznesit.

Afati përfundimtar për dorëzimin e formularëve të aplikimit për ide biznesi është në fund të fushatës informuese tre-javore. Ky afat shpallet qartësisht në të gjitha thirrjet publike për secilin cikël të projektit dhe formularin e aplikimit për ide biznesi. Formulari i aplikimit për ide biznesi i plotësuar (një origjinal dhe dy kopje) dhe dokumentet bashkëngjitur duhet të dorëzohen personalisht tek zyra e përtjetës me qytetarin në bashki, me orët e punës, në një zarf.

**Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm. Për aplikimet e marra me postë, e vlefshme është data e dërgimit (vula e postës). Aplikime të tilla pranohen edhe nëse merren pas afatit përfundimtar.*

Aplikimet pranohen sipas procedurave të mëposhtme:

Një verifikim formal i adresës, sipas shembullit të mësipër kryhet në sektorin e informimit dhe shërbimeve për qytetarët, dokumentet të cilat nuk kanë adresë, ose që kanë adresë të gabuar, nuk do të pranohen. Çdo kandidati i caktohet një numër reference me vulën e bashkisë.

4.2. Përzgjedhja e aplikantëve :

Shqyrtimi dhe vlerësimi i formularëve të aplikimit për ide biznesi do të kryhet nga komisioni i vlerësimit. Takimi do të organizohet nga koordinatori i projektit. Procesi për vlerësim administrativ dhe përzgjedhja e kandidatëve duhet të fillojnë jo më gjatë sesa dy ditë pune pas afatit përfundimtar për dorëzim të ideve të biznesit. Të gjithë anëtarët e komisionit duhet të jenë të pranishëm në takim. Procesi nuk duhet të zgjasë më shumë se tre ditë pune. Koordinator i projektit shpërndan të gjithë zarfat e marrë me aplikime dhe anëtarët e komisionit dhe koordinatori kontrollojnë së pari emrat e aplikantëve.

**Në rastin e duplikimeve të aplikimeve (më shumë se një aplikim për person) do të shpallet përfitues vetëm një aplikim, ai që ka idenë më të mirë të biznesit.*

Më pas, anëtarët e komisionit dhe koordinatori hapin të gjithë zarfat e mbetur dhe ndajnë të gjithë . në grupe – kompani të reja dhe ekzistuese (të regjistruara). Secili grup ndahet në 6

shtylla, sipas sektorëve të pranueshëm të biznesit. Aplikimet vlerësohen nga sektorët, e njëjta ndodh edhe me idetë e biznesit. Secili anëtar i komisionit do të vlerësojë secilën ide biznes individualisht sipas matricës së mëposhtme:

Formulari i vlerësimit të aplikimit (Aneksi 4) përbëhet nga tre seksione:

-Seksioni i parë mund të kontribuojë me një total prej 30 pikësh dhe mbulon aftësitë, zotësitë dhe përvojën personale të aplikantëve për të ushtruar aktivitete biznesi ose përvoja të mëparshme në menaxhimin e një biznesi;

-Seksioni i dytë i pyetjeve mund të kontribuojë me një maksimum prej 50 pikësh dhe i referohet realizueshmërisë së idesë së biznesit të kandidatit dhe njohurive të përgjithshme në fushën e sipërmarrjes;

-Seksioni i tretë, një total prej 20 pikësh mund t'i jepet idesë ose aplikantit bazuar në prioritetet e përgjithshme të vendosura nga projekti.

**Nëse gjatë procesit të vlerësimit konsiderohet se dokumentet e aplikantit janë të rreme, këta aplikantë do të përjashtohen menjëherë. Gjatë takimeve, Komisioni do të paraqesë arsye për refuzimin e ideve të biznesit për cdo aplikim.*

Pikët përfundimtare për secilën ide biznesi janë pikët mesatare të tre anëtarëve të komisionit.

Së fundi, komisioni rendit aplikantët për secilin grup veçmas sipas pikëve përfundimtare të secilës ide biznesi në rendin zbritës (nga aplikanti me pikët më të larta te ai me pikët më të ulëta).

****(Aplikantet me 70 pikë e lartë do të kualifikohen për të kaluar fazën e parë të përzgjedhjes)***

Kandidatët me të njëjtin numër pikësh të dhëna sipas metodës së mësipërme do të renditen sipas rendit të mëposhtëm:

1-Aplikimi me pikët totale më të larta të shënuara për prioritetet e projektit vijjnë të parat.

Nëse sërish ka balotazh:

2-Aplikimi me pikët totale më të larta të shënuara për grupin e parë të pyetjeve në Formularin e Aplikimit për Ide Biznesi vijjnë të parat. Nëse sërish ka balotazh:

3-Aplikimi me pikët totale më të larta të shënuara për grupin e dytë të pyetjeve në Formularin e Aplikimit për Ide Biznesi vijjnë të parat.

Aplikantët e parë nga secili grup, te reja dhe ekzistues, do të vazhdojnë përpara drejt hapit tjetër me pjesëmarrjen në trajnim, zhvillimin e planit të biznesit si dhe paraqitjen e planit të biznesit. Pas finalizimit të procesit të përzgjedhjes, koordinatori i projektit do të përgatisë listën përfundimtare të aplikantëve dhe do ta paraqesë atë me procesverbalin (Aneksi 5) në bordin e projektit për miratim brenda tre dite pune. Me miratimin, lista përfundimtare do të bëhet publike (në stendën faqen zyrtare dhe web të bashkisë, dhe vende të tjera publike).

Koordinatori i projektit do të kontaktojë me email ose telefon aplikantët që kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes, dhe do t'u kërkojë atyre të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në fazën e dytë të procesit të përzgjedhjes brenda 3 ditësh pune. Nëse disa nga aplikantët e pranuar nuk konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në kurset e trajnimit, vendet e tyre do të zihen nga aplikantët ndjekës në renditje. Vendet e grupit të trajnimit do të plotësohen sipas rendit të konfirmimit të pjesëmarrjes.

4.3. Paraqitja e planeve të biznesit

A-Formati i planit të biznesit :

Pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit, aplikantët do të fillojnë të punojnë individualisht me planet e tyre konkrete të biznesit duke ndjekur Formatin e Planit të Biznesit dhe të gjitha dokumentacionet përkatëse, që do t'i jepen secilit kandidat që arrin në këtë fazë. Planet e biznesit do të zhvillohen dhe dorëzohen gjatë periudhës katër-javore që pason datën e fundit të pjesës teorike të trajnimit. Gjatë kësaj periudhe, aplikantët mund të konsultohen me trajnuesit për planet e tyre të biznesit.

B-Dorëzimi i planeve të biznesit

Planet e biznesit duhet të dorëzohen jo më vonë se fundi i periudhës katër-javore për zhvillimin e tyre në sektorin e informimit dhe shërbimeve për qytetarët në bashki. Aplikimet mund të dorëzohen personalisht ose me postë në origjinal dhe në dy kopje të bashkëlidhura dhe të vendosura në një zarf .

**Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm. Për aplikimet e marra me postë, e vlefshme është data e dërgimit (vula e postës). Aplikime të tilla pranohen edhe nëse merren pas afatit përfundimtar.*

Aplikimet pranohen sipas procedurave të mëposhtme:

1-Një verifikim formal i adresës, sipas shembullit të mësipër kryhet në sektorin e informimit dhe shërbimeve për qytetarët, dokumentet të cila nuk kanë adresë, ose që kanë adresë të gabuar, nuk do të pranohen;

2-Çdo kandidat i caktohet një numër reference me vulën e bashkisë;

Koordinatori i Projektit merr informacion deri në afatin përfundimtar të dorëzimit të dokumentacionit nga sektorin e informimit dhe shërbimeve për qytetarët të gjitha aplikimet e marra (zarfa) dhe i ruan në zyrën e tij/saj pa i hapur ato, me qëllim ruajtjen dhe transparencën e gjithë procesit.

4.4. Vlerësimi dhe përzgjedhja e planeve më të mira të biznesit.

Verifikimi administrativ i planeve të dorëzuara të biznesit

Verifikimi administrativ i planeve të biznesit do të kryhet nga komisioni i vlerësimit. Takimi do të shpallet nga koordinatori i projektit. Procesi për vlerësim administrativ dhe përzgjedhjen e kandidatëve do të fillojë jo më vonë se dy ditë pune pas afatit përfundimtar të dorëzimit të planeve të biznesit. Të gjithë anëtarët e komisionit duhet të jenë të pranishëm në takim. Procesi do të zgjasë jo më shumë se një ditë pune.

Koordinatori i projektit shpërndan të gjithë zarfat me planet e biznesit dhe anëtarët e komisionit dhe koordinatori hapin të gjithë zarfat. Të gjithë anëtarët së bashku kryejnë një verifikim administrativ të secilit plan biznesi të paraqitur sipas 2 (dy) kritereve të përcaktuara në Listën e kontrollit të Formularit të Dokumenteve të Aplikimit për Grantin e marrë (Aneksi 7):

1. Verifikimi i plotësisë së dokumentit;
2. Formatit i planit të biznesit dhe bashkëngjitjet;
3. Përputhshmëria me kërkesat e projektit
4. Kriteret për pranueshmërinë e aplikantit;
5. Kriteret për pranueshmërinë e biznesit;
6. Niveli i përputhshmërisë midis planit të hartuar të biznesit me idenë origjinale të aplikantit për biznes.

7. Kur dokumentet e aplikimit nuk janë plotësuar ose nuk përputhen me kërkesat e projektit, aplikantët do të përjashtohen nga konkurrimi. Vetëm planet e biznesit që përmbajnë dokumentim të plotë dhe që janë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë do të pranohen nga eksperti i vlerësimit. Ky proces do të përfundojë brenda dy ditësh pune dhe koordinatori do të mbajë Procesverbalin e këtij takimi (Aneksi 8).
8. Kriteret për realizueshmërinë e planit të biznesit
9. Vlerësimi maksimal është 80 pikë, dhe matet nga elementët e mëposhtëm:
 10. Realizueshmëria financiare e biznesit;
 11. Burimet e disponueshme për biznesin – mjediset, pajisjet, furnizimet dhe personeli;
 12. Njohuritë lidhur llojin përkatës të biznesit;
 13. Vlerësimi i tregut.
 14. Kriteret prioritare për idenë e biznesit
 15. Vlerësimi maksimal është 20 pikë dhe merret nga formulari i vlerësimit të idesë së biznesit të secilit aplikant.
16. Secili plan biznesi duhet të vlerësohet nga dy këshilltarë. Vlerësimi nga ekspertë i planeve të biznesit do të përfundojë brenda një periudhe që mund të zgjasë maksimalisht deri në dhjetë ditë. Pikët përfundimtare të shënuara nga ekspertët i paraqiten koordinatorit të projektit.

Takimi i komisionit të vlerësimit :

Takimi i komisionit të vlerësimit do të organizohet nga koordinatori, jo më vonë se dy ditë pune pas marrjes së vlerësimit të ekspertëve. Nëse është e nevojshme, këshilltarët e vlerësimit, trajnuesit dhe/ose kandidatët mund të ftohen në takim për shpjegime të mëtejshme.

Komisioni i vlerësimit do të jape vlerësimin për secilin plan biznesi. Nëse është e nevojshme, mund të kërkohen informacione dhe dokumente shtesë për secilin plan biznesi. Aplikantët do të njoftohen me shkrim nga koordinatori për kërkesa të tilla dhe do u lihen në dispozicion pesë ditë pune për t'u përgjigjur. Aplikantët që nuk paraqesin dokumentet dhe/ose informacionet e kërkuara brenda periudhës së caktuar do të përjashtohen nga konkurrimi i mëtejshëm.

Komisioni bie dakord për vlerësimin përfundimtar të secili plan biznesi, që është mesatarja e dy vlerësimeve. Vlerësimi përfundimtar për plane të tilla biznesi janë pikët mesatare të dy vlerësimeve që ndryshojnë me më pak se 20 pikë (i pari dhe i treti ose dyti dhe i treti). Komisioni i vlerësimit përcakton pikët përfundimtare për secilin aplikant.

Së fundi, komisioni rendit planet e biznesit sipas pikëve përfundimtare të secilit plan biznesi në rendin zbritës për dy grupe aplikantësh – kompanitë start-up dhe ato ekzistuese (të regjistruara). Të gjithë aplikantët nga të dy grupet, planet e biznesit të cilëve kanë marrë vlerësime prej 70 pikësh ose më shumë, nga të cilat të paktën 60 pikë lidhen me kriterin e Realizueshmërisë, do të pranohen për financim deri në përfundimin e të gjitha financimeve të akorduara për këtë projekt. Nëse një nga grupet ka një numër të pamjaftueshëm të aplikimeve të suksesshme, financimi do t'i transferohet një grupi tjetër. Po ashtu nëse numri i atyre që kanë arritur të marrin më shumë se 70 pikë është më i vogël se numri i atyre që janë planifikuar për të përfituar, atëher komisioni mundet të rendise përfitues ata të cilët kanë arritur të renditen me pikë poshtë kufirit prej 70 pikëshit. Për këtë kategori komisioni do ti kërkojë eksperteve tju zhvillojnë të rinjve edhe një trajnim 1 javor ku të korigjojnë mangësitë e tyre. Në përfundim të trajnimit 1 javor eksperti do ti përgatisë një relacion komisionit se çfarë ka arrit ti zhvilloj më tepër këtij plani biznesi. Të gjithë anëtarët e komisionit duhet të bien dakord për rezultatet përfundimtare dhe listën e miratuar të planeve të biznesit për financim.

Pas finalizimit të procesit të vlerësimit, koordinatori do të përgatisë listën përfundimtare të aplikantëve dhe do ta dorëzojë atë së bashku me Procesverbalin e Takimit (Aneksi 10) në brenda tre ditësh pune.

Shpallja e rezultateve të konkursit :

Me miratimin e saj, lista përfundimtare do të bëhet publike (në stendën e njoftimeve, faqen e internetit të bashkisë dhe vende të tjera publike), gjithashtu do të njoftohet Kryetari i Bashkisë Himarë me listën përfundimtare të fituesve. Secili aplikant do të marrë një njoftim me shkrim (Aneksi 11), të përgatitur nga koordinatori i projektit, sipas opinionit të ekspertëve nga vlerësimet e planeve të biznesit. Pas botimit zyrtar të rezultateve, kandidatët mund të depozitojnë një apelim me shkrim në bashki brenda pesë ditësh pune nga marrja e njoftimit. Të gjitha apelimet e paraqitura brenda afatit përfundimtar shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit, që duhet të informojë aplikantin për vendimin dhe përfundimet e tyre me shkrim brenda pesë ditësh pune.

4.5. Kontraktimi dhe përdorimi i fondeve

Kontrata e grantit :

Procesi për regjistrimin e enteve ligjore (vetëm për bizneset e reja) dhe firmosja e kontratës së grantit do të koordinohet nga koordinatori dhe do të mbështetet nga drejtoritë si ajo Juridike dhe të asaj të financës, e planifikimit të buxhetit dhe e integritit evropian. Pas regjistrimit, të gjithë aplikantët e miratuar duhet të hapin një llogari bankare në emër të kompanisë së tyre.

Pas regjistrimit të entit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe hapjes së një llogarie bankare, kandidatët nënshkruajnë kontratën e grantit. Kontrata e standardizuar e grantit firmoset ndërmjet bashkisë dhe përfituesit për një periudhë kohore prej 18 muajsh që nga dita e nënshkrimit. Plani i biznesit dhe të gjitha bashkëlidhjet e miratuara nga komisioni vlerësues do të përbëjnë një pjesë integrale të kontratës së dhënies së grantit (Aneksi 13).

Aplikantët mund të dorëzojnë propozime për amendimin e kontratës, si dhe justifikime vetëm në rrethana të jashtëzakonshme te koordinatori i projektit, i cili do të informojë më pas komisionin e vlerësimit për propozimet e paraqitura. Komisioni do të vendosë për miratimin ose refuzimin e propozimit pasi të jetë konsultuar me drejtorinë juridike të Bashkisë Himarë. Nryshimet mund të bëhen vetëm gjatë periudhës së zbatimit të kontratës dhe nuk do të kenë fuqi prapavepruese. Ndryshimet e miratuara do të integrohen në një aneks të firmosur nga palët i cili do të përbëjë një pjesë integrale të kontratës.

Përdorimi i Grantit :

Bashkia do të transferojë grantin tek llogaria bankare e biznesit të përfituar të miratuar dhe transfertat në këtë llogari do të bëhen me dy (2) këste 50/50. Pagesat nga llogaritë bankare do të bëhen sipas kalendarit për përdorimin e grantit dhe kontributit të aplikantit (Seksioni X i Formatit të Planit të Biznesit). Aplikanti i miratuar duhet ta përdorë grantin brenda nëntë 9 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës së grantit. Kontrolli mbi detyrimet kontraktuale të aplikantëve të miratuar do të kryhet nga Drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë.

Pas përdorimit të secilit kështë të grantit, sipas kalendarit të miratuar për përdorimin e grantit dhe kontributit të aplikantit, Drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë, do të hartojë dhe verifikojë një raport të përkohshëm dhe përfundimtar për përdorimin e kontributit (Aneksi 14) për çdo kompani. Për të vërtetuar qëllimin e synuar dhe përkatësinë e shpenzimeve sipas parashikimeve në planin e biznesit, aplikanti i miratuar do të prezantojë një faturë dhe/ose një kontratë me një ofrues shoqëruar nga një dokument i pagesës bankare (konfirmim pagese ose urdhër pagese) për secilën blerje sipas kritereve të përzgjedhjes.

Nëse aplikanti e përdor grantin për qëllime të tjera, por jo për biznesin e miratuar ose përfundon aktivitetin e biznesit pa një arsye objektive (p.sh. shtrimi në spital për një kohë të gjatë, humbja e aftësive për punë si rrjedhojë e një aksidenti, arsye konkrete ekonomike, financiare, teknologjike ose të tregut të cilat i kalojnë mundësitë e kandidatit dhe që kanë një ndikim negativ në biznesin e tij/saj), Bashkia do të ndalojë menjëherë së financuari atë biznes dhe/ose do të fillojë një procedurë në gjykatën përkatëse për rikthimin e grantit.

4.7. Monitorimi dhe Vlerësimi :

Qëllimi i monitorimit të projektit, që mbulohet nga këto Udhëzime Operacionale, është të sigurojë informacion në kohë dhe të saktë nëse projekti është duke u zbatuar në përputhje me objektivat dhe kalendarin e tij;

Monitorimin e suksesit dhe efekteve të projektit të zbatuar:

Drejtoria e çështjeve sociale do të monitorojë zbatimin në kohë të të gjitha fazave të projektit, sipas kalendarit të miratuar nga bashkia. Informacioni i mbledhur gjatë këtij procesi monitorimi do t'i vendoset në dispozicion komisionit të projektit. Përfaqësues të komisionit të Bashkisë Himarë do të monitorojnë suksesin dhe efektet e zbatimit të projektit duke vizituar aplikantët e pranuar në këtë projekt. Çdo kompani do të vizitohet çdo muaj 9 muajt e parë, dhe më pas çdo tre muaj deri në fund të periudhës së kontratës 18 mujore) Vizitat në terren duhet të organizohen duke (dhe kur nevojitet pa) bërë përcaktimin paraprak të përfituesve, si dhe duke i njoftuar ata një deri në tre ditë para. I gjithë informacioni i mbledhur gjatë vizitave në terren do të reflektohet në një formular standard monitorimi (Aneksi 15). Komisioni do të diskutojë dhe do të marrë vendim për të gjitha vëzhgimet dhe çështjet e identifikuara gjatë vizitave në terren.

Këshilltari dhe mentorët për mbështetjen e biznesit do të përdoren si një burim informacioni kur përgatiten vizitat monitoruese. Gjatë vizitave në terren, do të kontrollohen sa më poshtë, të cilat do të parashtrohen me detaje në formularin e monitorimit:

- Ecuria e aktiviteteve në krahasim me planin e biznesit;
- Ndjekja e kalendarit të përdorimit të grantit dhe kontributit të aplikantit;
- Organizimi i biznesit;
- Verifikimi dhe dobia e shpenzimeve;
- Ndikimi i përdorimit të grantit, etj.

Një raport përfundimtar për projektin do të hartohet nga koordinatori në fund të çdo viti, duke përfshirë një analizë të projektit dhe rekomandime për ndryshimet.

Treguesit e mëposhtëm statistikorë do të monitorohen gjithashtu gjatë zbatimit të projektit:

- i. **Numri i dorëzuar i formularëve të aplikimit të ideve për biznes;**
- ii. **Numri i ideve për biznes të miratuara;**
- iii. **Numri i aplikantëve që janë trajnuar;**
- iv. **Numri i planeve të biznesit të dorëzuara;**
- v. **Numri i planeve të biznesit të dorëzuara përkundrejt numrit të aplikantëve që janë trajnuar;**
- vi. **Numri i planeve të biznesit të miratuara – veçmas për bizneset e reja dhe kompanitë ekzistuese dhe në total;**
- vii. **Shuma e financimit të lëvruar;**
- viii. **Numri i kontratave të firmosura të grantit;**
- ix. **Sektorët ekonomikë në të cilat funksionojnë kompanitë;**
- x. **Numri i vendeve të hapura të punës gjatë procesit të realizimit të idesë së biznesit;**

Këta tregues do të monitorohen gjatë çdo cikli projekti, si dhe për të gjithë projektin. Analiza krahasuese e rezultateve të arrira në çdo cikël pasues do të ofrojë informacion mbi dinamikën e projektit dhe ecurinë e tij.

Projekti do të vlerësohet në fund të dy viteve(18 muajve) sipas treguesve të mëposhtëm:

- Numri i të trajnuarve me aftësi të ndryshme biznesi,te rinjte
- Numri total i kompanive të mbështetura;
- Numri vendeve të punës të hapura;
- Arsyet për mbylljen e bizneseve (gjatë) pas dy viteve funksionim;
- Linjat e reja të biznesit të hapura brenda bizneseve ekzistuese;
- Përqindja e bizneseve që funksionojnë pas një viti pune;
- Investime të reja (aktivitete biznesi/linja biznesi shtesë, biznese të reja, etj.);
- Rezultatet e vlerësimit do të matin suksesin e Projektit.
- Anekset

Aneksi 1 – Njoftim publik

Aneksi 2 – Njoftim për takimet informuese

Aneksi 3 – Formular aplikimi për ide biznesi

Aneksi 4 – Formulari i vlerësimit për aplikimin e ideve të biznesit

Aneksi 5 – Procesverbali për vlerësimin e ideve të biznesit

Aneksi 6 – Format i plani të biznesit

Aneksi 7 – Listë kontrolli e dokumenteve të dorëzuara të aplikimit për grantin

Aneksi 8 – Procesverbali i takimit të verifikimit administrativ

Aneksi 9 – Formular i vlerësimit për planin e biznesit

Aneksi 10 – Procesverbal i takimit për vlerësimin e planit të biznesit

Aneksi 11 – Njoftim për aplikantët

Aneksi 12 – Kontrata për dhënien e grantit

Aneksi 13 – Raporti për përdorimin e grantit

Aneksi 14 – Formular monitorimi

Njoftim Publik

Projekti i bashkisë së himarës për fondin e projekti ‘Programi i nxitjes së punësimit të biznesit rinor.’

1.1 Hyrje

Në/...../..... (datë) Bashkia Hmarë do të fillojnë zyrtarisht projektin për fondin e programit të nxitjes së punësimit të biznesit rinor të Bashkisë Himarë, financuar nga programi i mbështetjes dhe nxitjes ekonomike ku do të shpallet thirrja e hapur për dorëzimin e aplikimeve për grante për projekte biznesi individuale të krijuara për të mbështetur krijimin, ose zgjerimin e aktiviteteve biznesi të suksesshme nga të rinjtë që janë të afta për të qenë të suksesshme në një treg konkurrues.

1.2 Rreth projektit të Bashkisë Himarë për fondin e programit të nxitjes së punësimit në ndihmë të krijimit të biznesit social rinor”

Qëllimi i projektit është të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga të rinjtë në Himarë, të cilat janë të afta që të mbijetojnë në një treg konkurrues. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve ka si qëllim të ofrojë transparencë dhe konkurrencë të barabartë si dhe të mbështesë idetë dhe planet e biznesit më të mira, të veçanta, fitimprurëse dhe që garantojnë rezultate të qëndrueshme. Përveç mbështetjes në formë granti, projekti do të ofrojë gjithashtu trajnim për aftësitë në biznes si dhe mbështetje duke ndihmuar të rinjtë me orientime profesionale dhe kualifikime për të qenë të suksesshme në fushën e përzgjedhur.

Projekti do të zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë dhe do të ketë kuota që do të kufizojnë numrin e aplikantëve dhe sasinë e financimit për t’u përdorur për bizneset e reja dhe bizneset ekzistuese (50/50).

1.3 Mbështetja e Projektit

Qëllimi i Projektit është të japë një mbështetje hap pas hapi për idetë e biznesit që kanë mundësinë më të madhe për të pasur sukses dhe për të tejkaluar barrierat e ndryshme të tregut. Për këto qëllime, projekti është ndarë në tre faza:

Faza e parë: Kandidatët e pranueshëm aplikojnë me idenë e tyre bazë për biznes, përmes Formularit të Aplikimit (shiko më poshtë).

Faza e dytë: Aplikantët e pranuar marrin pjesë në trajnim (10 gjysma ditë pune) për aftësi të përgjithshme biznesi dhe zhvillimin e planit të biznesit, dhe vetëm atëherë ata dorëzojnë planet e tyre të biznesit. Planet e biznesit do të jenë një version më i përpunuar i idesë për biznes dhe do të konkurrojnë për mbështetjen e grantit.

Faza e tretë: Fituesit e njoftuar do të firmosin një kontratë 18 mujore për të marrë financimin e grantit dhe mbështetje këshilluese.

1.4 Aplikantët e pranueshëm

Të gjithë aplikantët duhet të kenë një ide për biznes, që ka si qëllim fillimin ose zgjerimin e një biznesi të pavarur shumë të vogël ose të vogël. Ata janë të detyruar të marrin pjesë personalisht në të gjitha aktivitetet e Projektit, duke qenë se ata janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në zhvillimin dhe zbatimin e biznesit të tyre.

Kandidatët dhe pjesëmarrësit e pranueshëm të projektit janë të rinj që jetojnë në territorin e Bashkisë Himarë, që kanë një biznes shumë të vogël, ose duan të hapin një të tillë por që nuk kanë mjaftueshëm mbështetje financiare nga kapitali i tyre, në kohën e aplikimit.

Të rinjtë që nuk përmbushin kriteret për t'u përzgjedhur janë ato të cilat kanë një konflikt interesi me palët e përfshira dhe vendimmarrësit e projektit.

Çdo aplikant mund të marr pjesë me vetëm një ide biznesi, e drejta për të marrë pjesë në projekt dhe për të pasur akses në asistencën e grantit mund të përdoret vetëm një herë në vit. Aplikantet mund të jenë biznese start up dhe ekzistuese. Grupet e mëposhtme të të rinjve do t'u jepet prioritet:

- Të rinj /të reja (18-35 vjeç) dhe banorë efektivë të Himarës;(kriter kryesor)
- Të rinj nga zonat rurale të Bashkisë së Hmarës;
- Të rinj me aftësi të kufizuara;
- Të rinj dhe të reja, me njërin prind me aftësi të kufizuar ose gëzojnë statusin e jetimit.
- Të rinj dhe të reja të papunë që nuk u përkasin kategorive më lartë.
- Të rinj dhe të reja të rikthyer nga emigracioni ose që duan të rikthehen si një mundësi për të qëndruar në Himarë.

1.5 Aktivitete Biznesi të Pranueshme

- Aktivitetet e pranueshme të biznesit janë nga sektorët e mëposhtëm:
- Bizneset rurale;
- Turizmi;
- Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK);
- Biznes eco-friendly (miqësor me natyrën);
- Shërbime;
- Artizanale.
- Bujqësi

Sektorët mund të ndryshojnë përgjatë secilit vit, në varësi të prioriteteve të përcaktuara nga bashkia. Prioritet do u jepet aplikantëve:

- ✓ me ide biznesi unike (jo të përsëritura ndërmjet aplikantëve) ose që ofrojnë produkte/shërbime të reja,
- ✓ me biznese që ndodhen në zonat rurale të Bashkisë së Himarës,
- ✓ që përdorin zgjidhje teknike dhe teknologji prodhimi të reja dhe/ose që kursejnë energji,
- ✓ që përdorin burime të energjisë së rinovueshme
- ✓ me biznese që krijojnë më shumë se 3 mundësi punësimi dhe
- ✓ me biznese që japin mundësi punësimi kategorive vunerabël si gra të dhunuara etj.

Pavarësisht sektorit të zgjedhur, idetë e mëposhtme të biznesit nuk janë të pranueshme për të qenë pjesë e projektit:

- të gjitha llojet e aktiviteteve brenda sektorit parësor të bujqësisë;
- shërbime të pasurive të patundshme, qiraja për pasuri të tundshme;

- shërbime financiare dhe sigurimesh, dhe shërbime që përfshijnë lojërat e fatit;
- prodhim pijesh me përmbajtje dhe esencë të lartë alkooli;
- prodhim produktesh duhani;
- prodhim dhe shpërndarje armësh;
- prodhim duke përdorur teknologji që shkakton ndotje mjedisore (siç është ndotja e ajrit, ujit, tokës, etj.

